



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHËTËRËTOR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit: Institucioni i Shëndetit Publik Shtëpia e Shëndetit „Dr. Haim Abravanel“ Manastir

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë për mjetet nga fondi 737

Qëllimi i revizionit: Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

- mungesa e procedurave të punës dhe sistemi i pavendosur i kontrolleve të brendshme;
- regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar në tërësi;
- është dhënë në shërbim pajisje ISHP-së dhe është bërë largimi fizik i pajisjeve të vjetruara dhe të papërdorshme pa respektuar procedurat ligjore;
- për disa nga objektet nuk janë siguruar dëshmi për pronësi dhe as për listat e pronësisë;
- vaji për ngrohje në vlerë prej 900 mijë denarë nuk është i evidentuar në evidencën materiale dhe të kontabilitetit;
- parregullsi gjatë zbatimit të një pjesës nga prokurimet publik të materialeve laboratorike.

Mendimi i dhënë/përfundim *:



Është shprehur mendim me rezervë në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020.

Rekomandimet kyçe:

- vendosjen e kontrolleve dhe përgatitjen e procedurave të punës për proceset kyçe në Qendrën Shëndetësore;
- kryerjen e regjistrimit të plotë dhe dorëzimin në kohë të raportit nga i njëjti te personi përgjegjës;
- pajisjet e vjetruara dhe të papërdorshme të trajtohen në përputhje me procedurat ligjore;
- sigurimin e dëshmive për pronësinë dhe listave të pronësisë për disa nga objektet;
- evidentimi i materialit dhe kontabilitetit gjatë pranimit dhe konsumit të vajit për ngrohje;
- sigurimin e konkurrencës gjatë zbatimit të procedurave për prokurimin publik të materialeve laboratorike.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Pavarësisht ekzistimit të detyrimit ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë për vendosjen e sistemit kombëtar për punën materialo-financiare dhe të kontabilitetit në ISHP dhe sistem qendror për regjistrimin e orarit të punës për nevojat e ISHP-ve, ato nuk janë funksionale.

Vërejtjet e marra të draft-raportit: Nuk janë marrë vërejtje mbi draft-raportin e revizorit e autorizuar shtetëror numër 17-173/7 nga 13.12.2021.

* **pozitive**, **me rezervë**, **të pavolitshën**, **të përmbajtur**